

## Celësi i zgjidhjes Olimpiada Kombetare AML lenda Gjihe shqipe dhe letersi kl 12

Lënda: Gjuhë shqipe gjithsej 22 pikë

|            |            |        |
|------------|------------|--------|
| Pyetja 1   | A          | 1 pikë |
| Pyetja 2   | D          | 1 pikë |
| Pyetja 3   | A          | 1 pikë |
| Pyetja 4   | D          | 1 pikë |
| Pyetja 5.1 | D          | 1 pikë |
| Pyetja 5.2 | biblioteka | 1 pikë |

Pyetja 6 2 pikë

**Veçori strukturore:** Paragrafi I shërben si hyrje e tekstit informues-paraqitës

**Veçori gjuhësoro-stilistike:** komunikohet qartë, në mënyrë sintetike, të drejtpërdrejtë, përkufizimi i referentit (bibliotekë)

Pyetja 7 3 pikë

**Veçori leksikore:** Përdoren terma (katalog, libër, bibliotekë...); **ose** Fjalët përdoren në kuptimin e drejtpërdrejtë, pa ngjyrimë emocionale; **ose** përdoren përkufizime, shpjegime të kuptimit të fjalës (p.sh.: “katalog”).

**Veçori morfologjike:** foljet janë në kohën e tashme, kryesisht në mënyrën dëftore; **ose** foljet tregojnë gjendje

**Veçori sintaksore:** fjalitë janë të shkurtra; ose mbizotërojnë fjali të thjeshta (me një folje kallëzues)

Pyetja 8 2 pikë

Pyetja 8.a: Fjala **një** është përemër i pacaktuar. **1 pikë**

Pyetja 8.b: **BKF-ja**, një nga bibliotekat më të lashta që ka mbijetuar në Evropë, ka 13 milionë libra **1 pikë**

Pyetja 9 4 pikë

Pyetja 9.a Fjalja I: **Si** është ndajfolje Fjalja II: **Si** është lidhëz mënyrore **2 pikë**

Pyetja 9.b **Si** është fjalë jo e parme në fjalinë II, është e formuar me **konversion** nga ndajfolja **si** **2 pikë**

Pyetja 10 1 pikë

në **rafte** – përcaktor me drejtim **1 pikë**

Pyetja 11. 4 pikë

Rasti 1 - Në qoftë se na **duhet të gjejmë** dikë, para së gjithash pyesim për adresën e tij

**duhet të gjejmë** – kallëzues i përbërë modal **1 pikë**

**duhet** – folje gjysmëndihmëse modale që tregon modalitet të detyrimit. **1 pikë**

Rasti 2 – Në qoftëse do ta mësoni ta përdorni katalogun, atëherë do ta keni shumë të lehtë për të gjetur librin që ju **duhet**...

**duhet** – kallëzues i thjeshtë foljor **1 pikë**

**duhet** – folje më kuptim të plotë leksikor (nevojitet) **1 pikë**

**Celësi i zgjidhjes Lazgush Poradeci – Teksti I dyte**

**Lënda: Letërsi gjithsej 28 pikë**

|                 |          |               |
|-----------------|----------|---------------|
| <b>Pyetja 1</b> | <b>D</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 2</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 3</b> | <b>C</b> | <b>1 pikë</b> |
| <b>Pyetja 4</b> | <b>A</b> | <b>1 pikë</b> |

**Pyetja 5**                    **3 pikë**

-Në këto vargje gjuha është e *shënjtëruar, qiellore, jo e zakonshme*. Malli është në kuptimin lasgushian

-Natyra e lartë qiellore përforcohet në vargun tjetër (*vetëtimë e qiellit, fërfëllon, flakë*)

-Kuptimi plotësohet me cilësimet e tjera *djellë - i llaftuar që ndrin si pikë lot*.

Gjithë keto epitete plotësojnë njëri-tjetrin për të dhënë idenë e zjarrit, ndriçimit, djegies, sakrificës, mundimit, spatrimin (purifikimit) **si cilësi të gjuhës së zjarrtë**

**Pyetja 6**                    **2 pikë**

-Pikë loti në vargun e parë tregon pastërtinë, kullimin e gjuhës së zjarrtë, ndërsa në vargun tjetër, spastrimin, purifikimin e qenies që bie në kontakt me këtë gjuhë (*po ndrij në rreze tuaj*)

-Rimarrja e gjysmës së vargut të parë në rend të përmbysur lidh pastërtinë, si cilësi e gjuhës së zjarrtë, me spatrimin shpirtëror të atij që e “flet” këtë gjuhë.

**Pyetja 7**                    **3 pikë**

Fjala kyç: I huaj. Kuptimi i këtyre fjalëve lidhet me fjalën kyç të vargut *i huaj; këto dy fjalë pra këto dy gjendje janë pasoja të të qenurit i huaj , largimit nga gjuha e zjarrtë, gjuha poetike*                    **1 pikë**

Kuptimi i fjalës *i ndrydhur*: sepse kur largohesh nga gjuha, nga mjeti shprehës, mbetesh i pashpresë, i ndrydhur, i mbyllur në vetmi. Kuptimi i fjalës *i shkretë*: sepse kur je larg gjuhës, mjetit shprehës, mbetesh i vetëm, i pakuptuar prej të tjerëve.                    **1 pikë**

**Pyetja 8**                    **1 pikë**

Lagushi mrekullohet nga gjuha e zjarrtë. Prandaj fjala që mund ta zëvendësojë fjalën çudit është **“më mrekullon” ( ose më magjeps; ose më mahnit)**

**Pyetja 9**                    **2 pikë**

Nëpërmjet këtyre karakterizimeve deklarohet përlulësia e poetit përballë hyjnores, gjuhës poetike. Vetëm kështu, me përlulësi (*mjerush*) mund t’i afrohesh, të bëhesh pjesë e saj apo ta zotërosh. Nga ana, tjetër për të arritur përsosmërinë, për t’u bërë i denjë për këtë gjuhë të zjarrtë, është e mundimshme (*dyke vuar*)

**Pyetja 10**                    **3 pikë**

E shkruar dhe e folur, e kënduar                    **2 pikë**

**Vargu:** Kur të këndoje me gojë, kur të shkruaj në kartë.                    **1 pikë**

**Pyetja 11**                    **2 pikë**

Leximi dhe këndimi i kësaj Gjuhe të zjarrtë ( jo pa shkak e shkruar me të madhe) është dhimbje. Sic të dhemb kraharori kur merr frymë thellë, sic dhemb kraharori kur këndon me shpirt (Posi një kraharuar ti dhemb)

**Pyetja 12**                    **8 pikë**

| <i>Tabela e vlerësimit</i> | <i>Argumenti</i> | <i>Struktura</i> | <i>Stili/Origjinaliteti</i> | <i>Drejtshkrimi</i> | <i>Shuma</i> |
|----------------------------|------------------|------------------|-----------------------------|---------------------|--------------|
|                            | 2 pikë           | 2 pikë           | 2 pikë                      | 2 pikë              | 8 pikë       |
|                            |                  |                  |                             |                     |              |